



Policia e Shtetit



125



126



127



128



129



Lajmet e Fundit: **Tiranë – Vihen në pranga 2 shtetas**



Lajmet Operacionet

17/05/2022



Goditet një rast i armëmbajtjes pa leje, shpallet në kërkim pronari i një lokali në Kavajë.

Goditet dhe një rast i organizimit të lotarive të palejuara, arrestohet në flagrancë 19-vjeçari i punësuar në mënyrë të paligjshme në këtë lokal.

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak.

Specialistët për Hetimin e Krimit në Komisaratin e Policisë Kavajë, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative, se një shtetas mbante armë zjarri në lokal, kanë organizuar punën dhe kanë finalizuar operacionin policor të koduar “Black”.

Në kuadër të këtij operacioni u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit:

– A. Ç., 19 vjeç, banues në Kavajë, për veprën penale “Organizimi i lotarive të palejuara”.

Gjithashtu, u shpall në kërkim pronari i lokalit, shtetasi E. M., 40 vjeç, banues në Kavajë, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, “Organizimi i lotarive të palejuara” dhe “Punësimi i paligjshëm”.

Shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit në ambientet e lokalit të shtetasit E. M., gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë me municion luftarak. Gjithashtu, gjatë kontrollit të telefonit të shtetasit A. Ç., të cilin shtetasi E. M. e kishte punësuar në mënyrë të paligjshme në lokalin e tij, gjetën programe që shërbejnë për vendosjen e lotarive të palejuara.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.



 Share

 Share

 Share

 Share

 Email




Tiranë – Finalizohen dy operacione policore, të koduara “Camouflage 6” dhe “Camouflage 7” ▶

Kërko



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▼

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)



Copyright © 2022 Policia e Shtetit.